



---

**“ILLYRIAN GUARD” SH.A**

**Miratohet**

**ADMINISTRATORI**

**Robert LILI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCES VERBAL datë \_\_.\_\_.2022**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**“Radio komunikimi”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- **32000000-3-pajisje radio,televizion,te komunikimit,të telekomunikacionit dhe pajisje të ngjashme.**
  - **VLERA E FONDIT LIMIT: 6,800,000 (GJASHTË MILION E TETËQIND MIJË) LEK PA TVSH**
  - Sigurimi i ofertës 2% 136,000 e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 21, pika 2,

VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të urdhërit të prokurimit Nr. Prot 2067/11, Nr. 1747, datë 29.12.2022, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: “**Radio Komunikimi**” për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A ju informojmë për sa më poshtë:

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit të propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ne masen 2% te fondit limit;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për vitet financiare (2019-2020-2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në mbështetje të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të fondit limit të kontratës që prokurohet.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë:

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me një Ent Publik, Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën dhe faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitetet e duhura për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë

zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë certifikimet ISO si me poshtë:

- ISO 9001, për menaxhimin e cilësisë
- ISO 27001, për menaxhimin e sigurisë së informacionit
- ISO 20000-1 për menaxhimin e shërbimeve IT
- ISO-22301:2019 për sistemin e menaxhimit të vazhdimësisë së biznesit
  
- **ISO 20000-1, për menaxhimin e shërbimeve IT.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në menaxhimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit. Përbushja e standartit ISO 20000-1 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve. Ofrimi i shërbimit, i perket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këto ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efektive dhe në përputhje me kërkesat e Illyrian Guard shpk. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre), cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standartit kompanitë aplikojnë praktikën më të mirë, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

- **ISO 9001, për menaxhimin e cilësisë**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë.

Përbushja e standartit ISO 9001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e cilësisë së mallrave që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të cilësisë për shërbimet e ofruara dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të cilësisë. Nisur

nga proceset e punes dhe sherbimeve qe ai ofron, gjykohet e aryeshme qe operatori ekonomik proceset e punes se tij, ti bazoje ne standarde boterore, te cilat ne menyre direkte ndikojne ne cilesi, shpejtesi, efikasitet dhe te sherbimeve te ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori ekonomik zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë të kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

- **ISO 27001, per menaxhimin e sigurisë së informacionit**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën të jetë i certifikuar në sigurinë e informacionit.

Përmbushja e standartit ISO 27001 është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e te dhenave ne menyren e duhur. Ky lloj çertifikimi garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik permbush standartet per sigurine e informacionit gjate zbatimit te kontrates. Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përqsasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me focus tek siguria.

### **ISO-22301:2019 per sistemin e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit**

**Argumentimi:** ISO/IEC 22300 (Ky kriter e siguron AK që biznesi që do të marre persiper te realizoje kontraten eshte i besueshem se nuk do te nderprese vazhdimesine e aktivitetit te tij dhe te rrezikojte qellimin e ketij prokurimi ISO/IEC 22300:2019 ose ekuivalente.)

### **ISO duhet të jenë brenda periudhës së vlefshmërisë.**

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te kete te punesuar jo me pak se 8 punonjes ne listepagese. Per kete duhet te paraqese listepagesat e 3 muajve te fundit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për të garantuar implementimin e suksesshëm të kësaj procedure duhet qe specialistët e OE të sigurojne kapacitete njerëzore të nevojshme që priten të realizojë objektin e kontrates sipas kërkesave teknike dhe funksionale të përcaktuara.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 2 inxhinierë Inxhinieri Elektronike/Informatikë ose ekuivalente të fushës së IT.

*Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig për 3 muajt e fundit.*
- *Diplomat e arsimit të lartë të kërkuara, origjinale ose të noterizuara.*
- *Kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Inxhinierët Elektronik /Kompjuterik/Informatik janë përgjegjës për zbatimin e saktë të objektit që prokurohet bazuar ne njohurite e përgjithshme qe ofrojne keto fusha.

2.3. 5 Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes qe eshte i certifikuar per Sisteme Radio komunikimi Digjitale.

*Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig për 3 muajt e fundit.*
- *Certifikatën e kërkuar, origjinale ose të noterizuar.*
- *Kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Fusha e objektit te ketij prokurimi eshte Radiokomunikimi. Duke qene nje sistem, eshte i rendesishem fakti qe nje punonjes i certifikuar dhe i kualifikuar te garantoje funksionimin e tij bazuar ne njohurite specifike qe ka.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (nje) punonjes qe eshte i certifikuar per Sigurine Kibernetike.

*Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig për 3 muajt e fundit.*
- *Certifikatën e kërkuar, origjinale ose të noterizuar.*
- *Kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Pajisjet e kerkuara prodhojne, transmetojne dhe administrojne informacione te rendesishme dhe sensitive te cilat kerkojne nje sistem dhe administrim te sigurte te te gjitha te dhenave. Me kete kriter kerkohet te garantohet siguria e informacionit nga nderhyrje kibernetike

te qellimshme apo aksidentale. Per kete kerkohet qe implementimi te garantohet nga a punonjes te kualifikuar.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (një) punonjes te certifikuar per rrjetet IP (Network).

*Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig për 3 muajt e fundit.*
- *Certifikatën e kërkuar, origjinale ose të noterizuar.*
- *Kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Pajisjet dhe Sistemi funksionojne ne nje rjet IP Network per kete duhet qe operatori te kete punonjes te trajnuar dhe te certifikuar per rrjetet IP Network.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet te kete minimalisht 1 (një) punonjes qe jane te certifikuar në CCNA.

*Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig për 3 muajt e fundit.*
- *Certifikatën e kërkuar, origjinale ose të noterizuar.*
- *Kontratat e punës.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Pajisjet e kerkuara do te implementohen ne sistemin e sigurise ekzistuese, i cili ka nje rrjet komunikimi network te zgjeruar dhe shume cilesor i cili kerkon kompetenca te larta teknike per konfigurimin administrimin dhe monitorimin e paisjeve ne rrjet.

2.3.9 Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar për produktin e ofruar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për furnizimin/suportin e mallrave që do të përdoren për zbatimin e kontratës objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalën zyrtar të origjinës së mallrave/licensimeve specifike që kërkohen në këtë prokurim, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar edhe nga pikëpamja territoriale (pra për Shqipërinë) për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë shitëse dhe teknike.

**2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog ose skedë teknike ose broshurë nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi, të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor.**

Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do të paraqesë mallrat objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, dhe në mbështetje të pikës 6 pika b të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Katalogu/broshura teknike të përmbajë karakteristikat teknike të artikujve objekt prokurimi me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Në katalogun/broshurën teknike të paraqitur të evidentohen qartësisht në mënyrë të dukshme të gjitha specifikimet teknike të mallit të ofruar. Ky kriter shërben për të vërtetuar nëse malli i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

**2.3.11 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër realizimin e kontratës sipas afateve dhe kriterëve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikime teknike.**

**Argumentimi:** Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

## **Njesia e Prokurimit**